



**Datë:** 19.05.2025  
**Numër Protokolli:** 3299/2025

**A.nr.326/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 326/2025 të datës 18.02.2025 të parashtruar nga ankuesja L.Sh, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “Masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet** si e bazuar ankesa më numër A.nr. 326/2025 e datës 18.02.2025, e parashtruar nga ankuesja L.Sh.

**II. Shfuqizohet** Vendimi me numër protokolli 05-699, i datës 03.02.2025, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë.

**III. Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim A. Nr. 1635/2024, të datës 24.12.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses L.Sh, si të bazuar në ligj, duke e shfuqizuar vendimin me numër protokolli 05-7806 të datës 09.10.2024 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosjes tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, me konstatimet se vendimi i Komisionit Disiplinor të MSH nuk ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe juridike lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankueses

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim të zbatimit të vendimit A. Nr. 1635/2024, të datë 24.12.2025, të Këshillit me vendim me numër protokolli 05-699, të datës 03.02.2025, ankueses i shqipton masën disiplinore ‘‘ ulje në pozitë’’.

Ankuesja Laura Shehu, e pakënaqur me vendimin me numër protokolli 05-699 të datës 03.02.2025, të Komisionit Disiplinor më datë 18.02.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimor, duke përshkruar gjendjen faktike se si është ftuar në Komision disiplinor, pretendimet e ankues më shumë janë përshkrim se si është ftuar në komisionin disiplinor duke pretenduar se Vendimi i KPMSHCK-së ka aprovuar ankesën dhe nuk mund të rishqyrtohet rasti nga Komisioni.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.02.2025 ka dërguar përgjigje në ankesën tek Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli më datë 28.03.2025 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me tej Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendim me numër protokolli 2195/2025, të datës 02.04.2025, ka zgajtur afatin edhe për 10, ditë pune lidhur me ankesën e ankueses L.Sh.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ,me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova:** Ankesën A. Nr. 326/2025, të datës 18.02.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për L.SH; Vendimi me numër protokolli 05-699, i Komisionit Disiplinor; Vendimi A. nr.1635/2024, i datës 24.12.2024, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi A. nr.1684/2024, i datës 14.01.2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi me numër protokolli 05-121, i datës 10.01.2025, nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor; E- mali i datës 13.01.2025, dërguar nga L.SH, për A.V. D. G; etj; emali i datës 13.01.2025, dërguar nga A.M, për L.SH; Shkresa me numër protokolli 05-121/2, e datës 14.01.2025; E- mali i datës 20.01.2025, dërguar nga L.SH, për A.M; E- mali i datës 22.01.2025, dërguar nga A.V, për L.SH E- mali i datës 23.01.2025, dërguar nga L.SH, për J.G, M.S, etj; Vendim me numër protokolli 05-557, i datës 27.01.2025, lidhor me konfirmimin e masës disiplinore e nxjerr nga Zëvendësuesja e Drejtorit të Departamentit për Shërbime Shëndetësore dhe Shëndetit Publik i Ministrisë së Shëndetësisë; Njoftim me numër protokolli 05-563, i datës 27.01.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 28.02.2025, dërguar nga R.K, për H.S; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 326/2025, e datës 28.03.2025; Kopje e letërnjoftimit për L.Sh; Vendimi me numër protokolli 05-699, i Komisionit Disiplinor; Vendimi A.nr. 1639/2024, i datës 25.10.2024, i Këshillit; Vendimi A.nr. 1684/2024, i datës 14.01.2025, i Këshillit; Akt Emërimi me numër protokolli 05-10044, i datës 23.12.2024, për L.Sh; Vendimi me numër protokolli 1260, i datës 11.11.2024, i nxjerr nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Përshkrimi i detyrave të Punës për pozitën ‘‘ Udhëheqës i Devijonit për Shëndetit Publik’’; Deklarim me numër protokolli 05-7167, i datës 17.09.2024, për Komisionin Shëndetësore nga A.Q; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2023, për L.SH; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022, për L.SH; Letër referencë me numër protokolli 05-6436, i datës 13.10.2023,për A.Q; Kërkesë me numër protokolli 05-6840, për Inicimin e procedurës disiplinore për L.Sh; emali i datës 29.08.2024, dërguar nga L.Sh, për A.V, N.B etj; Deklaratë me numër protokolli 05-7141, i datës

16.09.2024, nga N.B,për Kryesuesin e Komisionit Disiplinor; emali i datës 14.12.2023, dërguar nga A.S.H, për L.SH; emali i datës 13.09.2024, dërguar nga M.S, për V.K; Emali i datës 05.02.2025, dërguar nga L.SH; Procesverbali i dates 29.01.2025, i Komisionit Disiplinor; Emali i datës 16.02.2025, dërguar nga A.M, për L.SH; Konfirmimi me numër protokolli 05-122, i datës 10.01.2025, dërguar nga J.G, për KPMSHCK; Deklaratë me numër protokolli 05-6840/2, e datës 12.09.2024, nga L.Sh, për Komisionin Disiplinor; Emali i datës 10.09.2024, dërguar nga A.M, për L.SH; emali i datës 26.07.2024, dërguar nga B.Sh, për N.B; emali i datës 28.07.2024, dërguar nga A.S.H, për B.S; Vendimi me numër protokolli 05-3213 i datës 26.04.2024, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë; emali i datës 14.02.2024, dërguar nga L.SH, për N.B; Vendimi me numër protokolli 05-4779 i datës 08.08.2024, i nxjerr nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë; emali i datës 18.12.2024, dërguar nga N.B, për M.K; emali i datës 14.12.2024, dërguar nga L.SH, për N.B; Vendimi me numër protokolli 05-2401 i datës 04.04.2024, i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimi me numër protokolli 05-2378 i datës 04.04.2024, i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimi me numër protokolli 05-2379 i datës 04.04.2024, i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimi me numër protokolli 05-2386 i datës 04.04.2024, i nxjerr nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; emali i datës 19.03.2024, dërguar nga N.B, për L.SH; emali i datës 12.03.2024, dërguar nga L.Sh për A.S.H; Kërkesë me numër protokolli 05-3203, i datës 26.04.2024, për pjesëmarrje në Konferencën e Shkencave Mjekësorë në Tiranë, dërguar nga L.Sh, për N.B; Vendimi me numër protokolli 2195/2025, i datës 02.04.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit me A.E nr.05-10044 të datës 23.12.2025, është i punësuar në pozitën e punës “Udhëheqëse e Divizionit të Shëndetit Mendor”, në Ministrinë e Shëndetësisë.

Tutje Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, me vendim A. Nr. 1635/2024, të datë 24.12.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses Laura Shehu, si të bazuar në ligj, duke e shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 05-7806, të datës 09.10.2024, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosjes tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë me qëllim të zbatimit të vendimit A. nr. 1635/2024, të datë 24.12.2025,të Këshillit me vendim me numër protokolli 05-699, të datës 03.02.2025, ankueses i shqipton masën disiplinore “ ulje në pozitë”.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në Ligjin Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht neni 86 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se “Shqyrtimi administrativ sipas detyrës zyrtare 1. **Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.** 2. **Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”** si dhe neni 89 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se “Mjetet e provës 1. **Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore.** 2. **Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen”,** fillimisht ka analizuar se Komisioni Disiplinor i MSH me vendimin nr. protokolli 05-699 të datës 03.02.2025 a ka marrë parasysh udhëzimet nga Vendimi i KPMSHCK-së, gjithashtu ka analizuar kërkesën për inicim disiplinor të datës. 04.09.2024, nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ndaj

ankueses lidhur me miellin e datës: 29.08.2024. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankues me datë 04.09.2024, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankueses si vijon citoj “ Dr. L.Sh. ka shkelur rëndë rregullat e komunikimit duke anashkaluar procedurat e brendshme dhe duke dërguar një email Ministrit të Shëndetësisë, ku ajo ka përfshirë në mënyrë të pa nevojshme edhe një pjesë të stafit të Ministrisë.....” Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt nuk e përmend në iniciimin e procedurës disiplinore, po nga shkresat e lëndës konstatohet se bëhet fjalë për emalin e datës 29.08.2024 të cilën ankuesja i ka drejtuar Ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm dhe disa zyrtarëve të MSH (në të cilin komunikim sipas emailit ka qenë edhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankueses).

Kolegji pasi ka analizuar emalin e datës 29.08.2024 ka konstatuar se ky email është komunikim i brendshëm në mesë zyrtarëve të MSH, ky email nuk është bërë publikë, MSH pretendon se përmes këtij email i është cenuar integriteti moral të apostrofuarëve, ndërsa në një rresht Komisioni Disiplinor në arsyetim shkruan se me këtë email i është cenuar integriteti fizik të apostrofuarëve në email, sipas Kolegjit meqenëse ky email është komunikim zyrtar dhe nuk është publikuar ankuesja nuk ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.08.L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 33 paragrafi 1, 2, 3 ku përcaktohet se “ Detyrimi për transparencë dhe konfidencialitet 1. **Zyrtarja/i publik ka detyrim të ushtrojë detyrën e saj/tij me transparencë të plotë dhe duhet të sigurojë për publikun çdo informacion të kërkuar, sipas legjislacionit përkatës për qasjen në dokumente publike.** 2. **Përrjashtëmish, zyrtarja/i publik obligohet të ruajë çdo informacion dhe dokument të klasifikuar, në përputhje me legjislacionin përkatës për klasifikimin e informacionit.** 3. **Zyrtarja/i publik nuk duhet të përdorë informacionin e siguruar gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera jashtë atyre të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.**

Kolegji i KPMSHCK-së ka shqyrtuar vendimin e Komisionit Disiplinor të MSH-së i cili vetëm ka përshkruar pretendimet e iniciuesit të procedurës disiplinore, deklaratën e Sekretarit të Përgjithshëm të MSH-së, vartëses së ankueses dhe të gjitha i ka marrë të mirëqena dhe ka shqiptuar masën disiplinore, nga shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se Komisioni ka administruar prova të mirëfillta në mënyrë që ta argumentoj të kundërtën e ankueses, Komisioni Disiplinor i MSH në vendimi e tij merret më tepër me krijimin e preceptcionit nga email i datës 29.08.2024 citoj “ Kjo sjellje krijon synimin e një perceptimi të pa saktë dhe të dëmshëm për Sekretarin e Përgjithshëm dhe zyrtarët tjerë të përmendur...”, gjithashtu ne vazhdim Komisioni disiplinor shkruan citoj “ Për më tepër Sinjalizuesi nga MSH në raportin e datës 24.09.2024, ka konstatuar se sjelljet e dhe veprimet e Znj. L.Sh ndaj Zonjës A.Q. kanë qenë diskriminuese, ofenduese, shtypëse, dukë përfshirë përdorimin e një fjalori fyes, denigrues dhe shpifëse”, Kolegji nga shkresat e lëndës konstaton se zonja A.Q ka bërë deklaratë ndaj ankueses L.SH me datë 16.09.2024 për Komisioni Disiplinor të MSH-së dhe e njëjta nga shkresat e lëndës nuk ka dëshmi sa ka ngritur shqetësim ndaj pretendimeve të Komisionit Disiplinor sa i përket ankueses, prandaj në dritën e këtyre fakteve Kolegji i KPMSHCK-së konstaton se Komisioni Disiplinor i MSH ka gjykuar këtë lëndë me hipoteza dhe me marrjen e deklaratave në mënyrë të njëanshme me qëllim që ankueses ti shqiptoj masën disiplinore.

Nga shkresat e lëndës dhe nisur nga fakti se emaili që pala ankuese e ka shkruar për të tërheq vërejtje për disa gjëra në kuadër të Divizionit të cilën e udhëheq ankuesja dhe meqenëse ky email ka qenë komunikim i brendshëm, Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor i MSH nuk ka mundur ta vërtetoj drejt gjendjen faktike dhe juridike sipas Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht neni 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.7 ku përcaktohet se “sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil”, sipas Kolegjit çështjet e ngritura nga ankuesja në email nuk përbejnë lidhje shkakësore në mesë emailit dhe dëmit të shkaktuar, sepse emaili ka qenë për komunikim zyrtar, ndërsa arsyetimi i Komisionit Disiplinor është mbështetur në tërësi në deklaratat e dhëna nga palët që e kanë pretendua ankuesen si shkelëse të supozuara pa bërë përpjeke adekuate që të verifikoj

pretendimet e ankueses, prandaj ngase u tha më lartë Kolegji konstaton se arsyetimi i vendimit të Komisionit Disiplinor është në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht neni 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, dhe 1.6 dhe paragrafi 2 Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim 1. ***Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.*** Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.326/2025**

**Rushit KAJTAZI**

**Procesmbajtës**

**Eshref SHABANI**

**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses L.Sh;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Njësisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së